



JOSEPH: KOSOVA SI MODEL PËR PAQEN NË UKRAINË



Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin "Johns Hopkins" në ShBA dhe ekspert i menaxhimit të konflikteve, propozon një qasje strategjike për të arritur paqe në Ukrainë, duke u bazuar në modelin e Kosovës. Ai e ka trajtuar këtë ide edhe në një analizë të publikuar në revistën akademike SAIS Review of International Affairs. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Joseph shpjegon se zbatimi i parimeve të Rezolutës 1244 në Donbas - administrimi ndërkombëtar, vendosja e trupave paqeruajtëse dhe shtyrja e çështjes së sovranitetit për më vonë - mund t'i ofrojë Ukrainës garanci sigurie pa pasur nevojë ta pranojë aneksimin rus të rajonit. Joseph vlerëson përpjekjet e administratës Trump, duke theksuar se ajo ka vënë në qendër arritjen e paqes në Ukrainë dhe ka sjellë dinamikë të re në procesin e negociatave

OPINION

TË POSHTËR DHE TË PAFYTYRË! F. 8

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



ZELENSKY NË PARIS E WITKOFFI NË MOSKË NË NJË "JAVË VENDIMTARE" PËR UKRAINË F. 2

EKONOMI



OEK-u I JEP ZRRE-SË PESË DITË AFAT: ZBATONI VENDIMIN E SUPREMES OSE DO TË DORËZOHJË KALLËZIM PENAL F. 7

HAMZA: KOSOVA DO TË KTHEHET NË UASHINGTON MË E FORTË SE KURRË F. 3



CAKOLLI THOTË SE VOTIMI VETËM NË PËRFAQËSI DIPLOMATIKE FORCON INTEGRITETIN ZGJEDHOR F. 5



KEDS-i FILLOI DYFISHIMIN E KAPACITETIT TË RRJETIT NË MALISHEVË F. 7

SPORT



BALLKANI, LIDER I SUPERLIGËS F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY NË PARIS E WITKOFFI NË MOSKË NË NJË ‘JAVË VENDIMTARE’ PËR UKRAINËN

PARIS, 1 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, mbërriti në Pallatin Elize në Paris të hënën paradite, për bisedime me homologun francez Emmanuel Macron, duke e nisur një tjetër javë të ngjeshur të diplomacisë, me synim për t'i dhënë fund luftës pothuajse katërvjeçare të Rusisë në Ukrainë. Zelensky shkoi në Paris me qëllim për t'i gjetur “kushtet për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme”, një ditë pas bisedimeve në Florida mes delegacioneve amerikane dhe ukrainase, të cilat, sipas të dyja palëve, ishin frytdhënëse. Palët nuk dhanë hollësi të mëtejshme për bisedimet në Florida.

“Javë vendimtare” për përpjekjet për paqe

“Ideja e përfundimit të luftës duke bërë disa lëshime ndaj Rusisë nuk do të funksionojë. Përkundrazi, kjo vetëm do ta nxisë Rusinë ta vazhdojë zgjerimin në drejtime të ndryshme”, tha të hënën për “Current Time”, Mykhailo Podolyak, këshilltar në zyrën e presidentit ukrainas. “Mendoj se një version disi më i qartë

kompromisi i nismës së [presidentit amerikan Donald] Trump për paqe, do të jetë në tryezë”, shtoi ai, duke iu referuar një plani të propozuar nga Shtëpia e Bardhë në mes të nëntorit, i cili e ka shkaktuar këtë valë diplomacie. Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha të hënën se “kjo mund të jetë javë vendimtare” për përpjekjet për paqe. I dërguari i posaçëm amerikan, Steve Witkoff, një anëtar i ekipit amerikan në Florida, do të zhvillojë bisedime me presidentin rus Vladimir Putin të martën, sipas zëdhënësit të Kremlinit, Dmitry Peskov. Ky do të jetë takimi i gjashtë i Witkoffit me Putinin që nga janari. Propozimi fillestar amerikan me 28 pika shqetësoi zyrtarët ukrainas, dhe thuhet se zemëroi Zelenskyn. Zyrtarët ukrainas më pas zhvilluan bisedime me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio, dhe zyrtarë të tjerë amerikanë në Gjenevë më 23 nëntor. Ato bisedime rezultuan në një plan me 19 pika që lë disa çështje të mëdha ende të pazgjidhura, përfshirë fatin e një pjese të rajonit Donbas të Ukrainës, synimet e Ukrainës për të hyrë në NATO dhe një kufi



të mundshëm për madhësinë e forcave të armatosura të Kievit. Ato u pasuan nga bisedimet në Florida një javë më vonë.

Rusia gjen “kënaqësi” në skandalin në Ukrainë

Për Ukrainën, një ndërlikim shtesë ka qenë polemika në të cilën është përfshirë shefi i stafit të Zelenskyt, Andriy Yermak, i cili ka luajtur rol kyç në bisedime. Yermak - i cili nuk është akuzuar nga hetuesit dhe ka thënë se nuk ka bërë asgjë të gabuar - dha dorëheqje më 28 nëntor pas hetimeve të vazhdueshme për korrupsion. Ai udhëhoqi delegacionin ukrainas në

Gjenevë, por nuk ishte pjesë e ekipit në Florida. Podolyak, i cili ishte këshilltar i Yermakut, i tha “Current Time” se Rusia po përfiton nga skandali i korrupsionit. “Ata gjithmonë investojnë në nxitjen e konfliktit të brendshëm në Ukrainë, duke e fryrë atë sa më shumë të jetë e mundur. Ata dinë si ta bëjnë këtë, kanë shumë platforma informuese, rrjete sociale që i përdorin për këtë. Dhe, sigurisht, tani e shikojnë këtë konflikt të brendshëm me kënaqësi”, tha ai. Trumpi më 30 nëntor paralajmëroi se skandali nuk ishte i dobishëm për procesin e paqes, duke shtuar se “Ukraina ka disa probleme të vogla të vështira”.

E derisa diplomacia po forcohet, vrasjet po vazhdojnë. Autoritetet ukrainase raportuan të hënën se tre persona u vranë dhe tetë u plagosën në një sulm me raketa ruse në Dnipro. Ndërkohë, zëdhënësi i Kremlinit, Peskov, u ankua për sulmet ukrainase me dronë ndaj infrastrukturës së naftës në Rusi. Ai tha se një sulm gjatë fundjavës ndaj infrastrukturës së Konsorciumit të Tubacionit të Kaspikut (CPC) ishte “skandaloz duke pasur parasysh rëndësinë e tij ndërkombëtare dhe përfshirjen e partnerëve ndërkombëtarë”, përfshirë kompaninë amerikane të naftës “Chevron”. Kazakistani, një partner në projekt, paraqiti një protestë zyrtare ndaj qeverisë ukrainase për sulmin, të cilin e quajti “akti i tretë i agresionit ndaj një objekti krejtësisht civil”. Në të kaluarën Kievi ka thënë se shënjestron industrinë e naftës për t’ia kufizuar Rusisë të ardhurat për financimin e luftës. Në anën tjetër, Moska e ka mohuar se synon objektiva civile në Ukrainë pavarësisht prej provave të shumta të sulmeve ndaj shkollave, spitaleve, banesave dhe objekteve të tjera qëkurse e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës në shkurt 2022.

NETANYAHU DEL PARA GJYKATËS TEKSA PRESIDENTI IZRAELIT SHQYRTON KËRKESËN E TIJ PËR FALJE

JERUSALEM, 1 DHJETOR - Presidenti i Izraelit, Isaac Herzog, ka thënë të hënën se do të përqendrohet vetëm tek “interesat më të mira të Izraelit” kur ta shqyrtojë kërkesën e kryeministrit Benjamin Netanyahu për ta falur për akuzat për korrupsion. “Do të shqyrtohet në mënyrën më të drejtë dhe më të saktë. Unë do t'i marr parasysh vetëm interesat më të mira të Shtetit të Izraelit dhe të shoqërisë izraelite”, tha Herzog në një

deklaratë. Netanyahu njoftoi të dielën se kishte paraqitur kërkesën për falje, duke thënë se çështjet e gjata gjyqësore po e copëtonin Izraelin. Ndërkohë, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i shkroi muajin e kaluar Herzogut, duke i kërkuar ta falë Netanyahun. Netanyahu i ka mohuar vazhdimisht akuzat për korrupsion. Ai dhe bashkëshortja



e tij Sara akuzohen në një rast se kanë pranuar më shumë se 260 000 dollarë në formë dhuratash luksoze si puro, bizhuteri dhe shampanjë nga miliarderë në

këmbim të favoreve politike. Kryeministri akuzohet se ka kërkuar të negociojë mbulim më të favorshëm mediatik nga dy media izraelite në dy raste të tjera. Meqenëse çështjet kanë nxjerrë në pah përçarje të thella në shoqërinë izraelite midis mbështetësve dhe kundërshtarëve të tij, Netanyahu tha se po kërkon që të falet në mënyrë që t'i “ulë tensionet dhe ta promovojë

pajtimin që vendit tonë i duhet kaq shumë”. Netanyahu e ka mohuar vazhdimisht fajësinë në rastet gjyqësore dhe nuk e pranoi fajësinë as të dielën kur njoftoi se i ka kërkuar presidentit ta falë. Ai doli para gjykatës në Tel Aviv, ku protestues për dhe kundër tij brohoritën slogane. Disa prej protestuesve ishin të veshur me uniforma ngjyrë portokalli të stilit të të burgosurve.

RUBIO PAS PËRFUNDIMIT TË TAKIMEVE SHBA - UKRAINË: DUHET MË SHUMË PUNË

UASHINGTON, 1 DHJETOR - Zyrtarë të lartë amerikanë dhe ukrainas i kanë përfunduar takimet e tyre në Florida, të cilat sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i ka përshkruar “shumë produktive”, ndonëse nevojitet punë shtesë për të finalizuar një plan për përfundim të luftës së Rusisë në Ukrainë. “Kemi pasur një tjetër takim shumë produktiv, nisur nga bisedimet në Gjenevë, më pas takime të

tjera të javës, por duhet bërë më shumë punë”, u ka thënë Rubio gazetarëve më 30 nëntor, pas takimit, por pa ofruar më shumë hollësi. “Ka shumë gjëra që po ndryshojnë, dhe natyrisht që është edhe një palë tjetër e përfshirë këtu që duhet të jetë pjesë e ekuacionit”, ka thënë ai, duke iu referuar Rusisë. “Do të vazhdojmë edhe këtë javë, kur [i dërguari i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë,

Steve] Witkoff udhëton në Moskë... ne kemi qenë në kontakt me nivele të ndryshme brenda anës ruse, por duket se i kuptojmë mirë edhe qëndrimet e tyre”, ka thënë Rubio. Sekretari i Këshillit të Sigurisë të Ukrainës, njëherësh lideri i delegacionit të Kievit, Rustem Umerov, i ka përshkruar negociatat si “të suksesshme”, por as ai nuk ka ofruar më shumë hollësi.



HAMZA: KOSOVA DO TË KTHEHET NË UASHINGTON MË E FORTË SE KURRË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka përmbyllur vizitën dyditore në Uashington, të cilën e ka cilësuar jashtëzakonisht të rëndësishme për “vizionin e partneritetit të ri” në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Hamza ka deklaruar se agjenda ka qenë intensive, në fokus të së cilës kanë qenë “takime të nivelit të lartë” me përfaqësues të Shtëpisë së Bardhë, Këshillit Kombëtar të Sigurisë dhe Departamentit Amerikan të Shtetit. Ai ka njoftuar se ka takuar edhe ekspertë të lartë nga



fondacioni konservator amerikan ‘Heritage’ në Uashington. “Dje e përfundova vizitën time të shkurtër dyditore në Washington D. C. Agjenda ishte intensive dhe e konsiderova jetike të paraqes vizionin tim për zhvillimin e Republikës dhe rindërtimin e partneritetit të thellë mes Kosovës dhe administratës amerikane”, ka njoftuar Hamza. Ai ka shprehur optimizëm për ‘fazën e re’ të bashkëpunimit në mes të Prishtinës dhe Uashingtonit, duke shtuar se vizita ka konfirmuar gatishmërinë e qeverisë amerikane për projekte të reja dhe investime konkrete që do ta forcojnë pozitën e Kosovës. “Kosova

do të kthehet në Washington më e fortë se kurrë, me projekte konkrete, me investime të prekshme dhe me përfshirjen e SHBA-së në zhvillimin e hovshëm të Kosovës në diplomaci, ekonomi, sektorin e energjisë, ushtri dhe inteligjencë”, ka shkruar Hamza. Vizita e kandidatit të PDK-së për kryeministër vjen në prag të hapjes së fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të cilat janë caktuar të mbahen më 28 dhjetor dhe në një kohë kur marrëdhëniet midis administratës amerikane dhe ekzekutivit të Kosovës kanë përjetuar një valë sizmike tensionesh dhe mosmarrëveshesh.

KURTHI I FAJDEVE: PASOJAT SHKATËRRIMTARE TË HUAVE ILEGALE

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Për shkak të një krize financiare, Izeti mori 2 000 euro fajde. Por, nga kjo shumë, në fund ai ktheu gjysmë milioni dhe e humbi biznesin. Mungesa e kapitalit dhe vështirësitë në marrjen e kredive formale vlerësohet se kontribuojnë në marrjen e fajdeve. Ekspertët thonë se pasojat e fajdeve janë afatgjatë për ekonominë. I gjendur përballë një krize të thellë financiare në biznesin e tij dikur të madh, dhe pasi një bankë komerciale ia refuzoi kërkesën për kredi, një qytetar nga Rrafshi i Kosovës kërkoi shpëtimin te fajdexhinjtë. Fillimisht mori vetëm 2 000 euro - një shumë që dukej e vogël për ta mbajtur gjallë biznesin - por, më pas, edhe 150 mijë euro të tjera. Çdo hua të re e merrte për ta paguar të vjetrën, dhe borxhi vetëm sa rritej. “Për gati pesë vjet kam paguar mbi 500 mijë euro me fajde, për 20 persona të ndryshëm”, thotë Izeti [emër i vendosur nga redaksia], 60-vjeçar. Përveç shumës së paguar, ai humbi biznesin, objektin ku vepronte, dhe pasuri të tjera, që kapin vlerën e një milion eurove. Shtëpinë - pasurinë e vetme të patundshme që i ka mbetur - e ka lënë hipotekë në një bankë për të marrë kredi me të cilën pagoi fajdetë. Në qytetin e tij të vogël, thotë ai, është shumë e thjeshtë të marrësh para me fajde, sepse fajdexhinjtë janë të shumtë dhe të njohur nga të gjithë. Por, sipas tij, fajdetë janë “vdekje për së gjalli”. Forcën për ta

kapërcyer situatën e ka gjetur vetëm te fëmijët. “Bukë e kripë hani, e mos merrni para me fajde”, thotë Izeti, i cili u përball për gati një dekadë me borxhet ilegale.

Huamarrja ilegale, problem serioz në Kosovë

Rasti i Izetit nuk është i izoluar. Në Kosovë shpesh raportohen aktakuza kundër personave të dyshuar për fajde, ndërsa përmenden miliona euro dëme. Vetëm në tetor të këtij viti autoritetet ngritën aktakuza në dy raste të ndara, ku tetë persona dyshohet të kenë shkaktuar dëme deri në 8 milionë euro. Prokuroria kërkoi konfiskimin dhe kthimin e 21 banesave dhe lokaleve afariste, që të dëmtuarit ua kishin dhënë fajdexhinjve, pasi nuk mund t'i kthenin borxhet. Avokatja Xhevahire Miftari Kloppner thotë se shumë qytetarë bien pre e fajdeve për shkak të mungesës së qasjes së shpejtë në kredi formale - sidomos ata me të ardhura të ulëta ose pa pasuri për hipotekë. Sipas saj, në disa raste qytetarët mendojnë se po marrin një borxh të zakonshëm, por më pas përballen me norma interesi që shkojnë deri në 20 për qind në muaj. Shpesh viktimat janë afaristë që kërkojnë ta zgjerojnë biznesin, por në pamundësi të shlyerjes së borxhit, detyrohen ta mbyllin dhe t'i humbin pronat. Me rritjen e borxhit fajdexhinjtë shpesh ushtrojnë presion, kërcënime dhe marrje të pasurisë me forcë.



Disa persona, madje, janë detyruar ta braktisin Kosovën.

Sfidat e hetimit

Të dhënat e Policisë se Kosovës tregojnë se gjatë periudhës janar-shtator 2025 janë hapur 13 raste për fajde. Vitin e kaluar ky numër ishte 23, kurse më 2023 autoritetet kishin hapur 24 raste. Gjatë viteve 2021-2023 Policia ka shkatërruar 106 grupe kriminale, prej të cilave nëntë merreshin me fajde. Nga 740 të dyshuar për krim të organizuar, 78 ishin të përfshirë në këtë veprimtari - shumica në rajonin e Prishtinës dhe të Pejës. Sipas Miftari Kloppnerit, numri i rasteve reale është shumë më i lartë, sepse shumë të dëmtuar kanë frikë t'i raportojnë. Por, monitorimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) tregon se gjatë 2025-s ka pasur rritje të rasteve të paraqitura nga qytetarët falë bashkëpunimit më të ngushtë mes prokurorive dhe përdorimit të masave të fshehta të hetimit. Flamur Kabashi, hulumtues në IKD, thotë se një sfidë e madhe mbetet fakti që shumë të

dëmtuar nuk u qëndrojnë deklaratave të dhëna në prokurori, pasi përballen me presion. Sipas tij, gjykatat shpesh nuk bëjnë ballafaqimin e deklaratave, gjë që e dobëson procesin. IKD vlerëson se Prokuroria Themelore në Prizren ka shënuar progresin më të madh në hetimin e rasteve të fajdeve dhe se ky model duhet të ndiqet nga të gjitha prokuroritë e vendit. Sipas Kodit Penal të Kosovës, fajdexhinjtë dënohen me gjobë dhe me burgim nga 6 muaj deri në 12 vjet varësisht nga shkalla e dëmit. Megjithatë, sipas të dhënave të ofruara më herët nga ish-ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në gusht të këtij viti, nga 1 752 persona të burgosur, vetëm katër ishin të dënua për fajde dhe tetë mbaheshin në paraburgim. “Këto nuk janë thjesht vepra të izoluar, janë pjesë e një zinxhiri kriminal, që godet më të pambrojturit dhe kontribuon në një ndjenjë të thellë padrejtësie në shoqëri”, kishte deklaruar Haxhiu. Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk iu përgjigj interesimit të

REL-it se sa është numri i të burgosurve aktualisht për veprën penale “fajde”.

Plagë që dëmton ekonominë

Ekspertët thonë se dënimet për fajde duhet të ashpërsohen për të krijuar pengesë reale ndaj huadhënësve ilegalë. Shkumbin Misini, profesor i Ekonomisë në Kolegjin AAB, thekson se bizneset që përballen me mungesë kapitali ose vështirësi për marrjen e kredive formale shpesh bien pre e fajdeve. Normat e larta të interesit - 20 për qind mujore dhe deri në 200 për qind vjetore - janë, sipas tij, shkatërrimtare. “Asnjë biznes nuk mund t'i përballojë këto norma. Dhe, për ta kthyer borxhin e fajdeve, bizneset punojnë, por me humbje, dhe falimentojnë, ndërsa fajdexhinjtë marrin pronat, makineritë, aksionet e kompanisë”, thotë ai. Sipas tij, pasojat janë afatgjatë për ekonominë: ulin investimet formale, rrisin qarkullimin e parave jashtë sistemit bankar, pakësojnë tatimet dhe dëmtojnë stabilitetin financiar të vendit. Miftari Kloppner thekson se për të adresuar në mënyrë efektive fenomenin e fajdeve nevojiten ndryshime në legjislacion. Ajo sugjeron që ligji t'i përcaktojë qartë përgjegjësitë e të dy palëve të përfshira, me qëllim forcimin e zbatueshmërisë dhe uljen e praktikave të huadhënies jashtë kornizës ligjore.



JOSEPH: KOSOVA SI MODEL PËR PAQEN NË UKRAINË

Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin “Johns Hopkins” në ShBA dhe ekspert i menaxhimit të konflikteve, propozon një qasje strategjike për të arritur paqe në Ukrainë, duke u bazuar në modelin e Kosovës. Ai e ka trajtuar këtë ide edhe në një analizë të publikuar në revistën akademike SAIS Review of International Affairs. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Joseph shpjegon se zbatimi i parimeve të Rezolutës 1244 në Donbas - administrimi ndërkombëtar, vendosja e trupave paqeruajtëse dhe shtyrja e çështjes së sovranitetit për më vonë - mund t'i ofrojë Ukrainës garanci sigurie pa pasur nevojë ta pranojë aneksimin rus të rajonit. Joseph vlerëson përpjekjet e administratës Trump, duke theksuar se ajo ka vënë në qendër arritjen e paqes në Ukrainë dhe ka sjellë dinamikë të re në procesin e negociatave

PRISHTINË, 1 DHJETOR -

Z. Joseph, ju propozoni zbatimin e modelit të Kosovës në Donbas. Cili është mësimi më i rëndësishëm nga Kosova që besoni se mund të zbatohet në Ukrainë sot?

Edward P. Joseph: Gjëja më e rëndësishme dhe më interesante e përdorimit të modelit të Kosovës në Donbas - pra në Ukrainë - për të arritur një armëpushim, është se presidenti rus [Vladimir] Putin e mbështet atë. Kjo është pika fillestare, por jo e vetmja. Putin, për më shumë se dy dekada, ka insistuar se duhet të respektohet Rezoluta 1244. [v.j. Me këtë rezolutë të vitit 1999 është urdhëruar tërheqja e trupave të Republikës Federale të Jugosllavisë nga Kosova dhe vendosja e Kosovës nën administrimin e Kombeve të Bashkuara]. Putin, gjithashtu, ka përsëritur vazhdimisht se Kosova

dhe Ukraina janë e njëjta gjë. Ideja e përdorimit të një modeli është krejtësisht e përshtatshme. Administrata amerikane po merr elemente nga plani për Gazën. Por, unë mendoj se modeli i Kosovës është shumë më relevant se ai i Gazës. Modelin e Kosovës edhe vetë Putin e di shumë mirë.

Por, kritikët argumentojnë se Kosova ka qenë një rast unik, me një konsensus të fortë ndërkombëtar, ndryshe nga Ukraina. Pse besoni se një model i tillë mund të funksionojë gjithsesi?

Edward P. Joseph: Rezoluta 1244 e nxori çështjen e sovranitetit jashtë diskutimit, pa e mohuar apo shpallur pavarësinë e Kosovës, por duke i dhënë fund konfliktit dhe duke hapur rrugë administrimit ndërkombëtar dhe pranisë së trupave

paqeruajtëse në Kosovë. I njëjti parim do të zbatohet edhe në Donbas dhe debati se ‘kujt i përket’ ai do të shtyhet për më vonë - me një referendum të ardhshëm për ta zgjidhur. Putin i mbështet referendumet - ai i ka organizuar ato edhe në Krime, edhe në pjesët e Donbasit që Rusia i kontrollon. Pra, atij do t'i serviroshin dy gjëra që s'i kundërshton: modeli i 1244-shit dhe referendumi. Me këtë model, do të mund të fitonte edhe më shumë territor, sipas mendimit tim - madje edhe më shumë sesa ofron plani i [presidentit amerikan, Donald] Trump. Do të mund të fitonte edhe zonat e Donbasit perëndimor, që për Ukrainën janë më të ndjeshmet, sepse me kontrollin e tyre, Rusia do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në të gjithë vendin dhe, madje, do të mund të hapte një tjetër

rrugë drejt Kievit. Por, atij do t'i duhej të pranonte edhe një kusht - ngjashëm siç ka bërë Kosova. Do të duhej të pranonte administrimin [e Donbasit] nga një palë e tretë - qoftë nga OKB-ja, qoftë nga OSBE-ja. Rusia është anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit dhe ndoshta i pëlqen administrimi i OKB-së, pasi vazhdimisht insiston që UNMIK-u duhet të mbetet në Kosovë.

Mendoni se Ukraina do të pranonte një plan të tillë?

Edward P. Joseph: Për Ukrainën do të ishte një qasje e favorshme. Arsyeja e parë: Kyvi nuk do të duhej ta njihte aneksimin rus të Donbasit. Pastaj, statusi i Krimesë mund të lihej për negociata të mëvonshme, meqë shanset për ta rikthyer ushtarakisht janë minimale. Arsyeja e dytë, dhe më e rëndësishmja për presidentin ukrainas [Volodymyr] Zelensky, janë garancitë e sigurisë. Modeli i Kosovës do të sillte administrim ndërkombëtar nga OKB-ja ose OSBE-ja, që do ta ndalte menjëherë rusifikimin - detyrimin për pasaporta ruse, indoktrinimin ushtarak të fëmijëve dhe pengesat për të zhvendosurit që duan të kthehen në shtëpitë e tyre. Nën këtë administrim do të krijoheshin edhe komisione ndërkombëtare për pronat. Ashtu si në Kosovë, në Donbas

do të vendoseshin trupat paqeruajtëse dhe për t'i bërë më të pranueshme për Rusinë, këto trupa do të mund të vinin nga Afrika ose Azia, jo domosdoshmërisht nga Evropa. Pra, thelbi i gjithë kësaj është se, kur çështja e sovranitetit lihet përkohësisht anash, çdo element tjetër bëhet shumë më i lehtë për t'u negociuar.

A keni pasur rastin ta diskutoni këtë ide me ndonjë zyrtar amerikan, apo me ndonjë burim zyrtar?

Edward P. Joseph: Kjo është një pyetje shumë e mirë, por nuk mund ta konfirmoj se kam pasur bisedime të tilla, sepse mund të pasojë pyetja juaj: me kë? Mund të them vetëm se do të ishte krejtësisht logjike dhe natyrale për mua që ta diskutoja këtë çështje me zyrtarë amerikanë.

Si i shihni përpjekjet aktuale të administratës amerikane për paqe në Ukrainë?

Edward P. Joseph: Propozimi i administratës Trump nis nga premisa se Rusia është pala më e fortë dhe Ukraina pala më e dobët, prandaj i gjithë procesi duhet të ndërtohet rreth kërkesave dhe pozicionit të Rusisë.

Tani, gjëja pozitive - dhe presidentit Trump duhet t'i jepen merita për këtë - është se ai, ndryshe nga [paraardhësi i tij, Joe] Biden, i jep përparësi arritjes

së paqes. Kjo është një gjë e mirë dhe ka sjellë një dinamikë të re. Ka krijuar ndjesinë se e gjithë kjo ka të bëjë me përfundimin e luftës. Nuk ka të bëjë me mposhtjen e Rusisë apo me dhënien e ndonjë mesazhi për rendin global... Por, problemi është se ndërtimi i një marrëveshjeje duke u bazuar vetëm te pala më e fortë nuk prodhon rezultatin më të mirë, nëse qëllimi është një zgjidhje e qëndrueshme. Një marrëveshje e tillë rrezikon ta shtyjë Ukrainën drejt 'dorëzimit të heshtur'. Një qasje më e zgjuar do të ishte kombinimi i gatishmërisë për të negociuar me Putinin me fuqizimin paralel të Ukrainës dhe rritjen e presionit ndaj Rusisë. Trump, në fakt, i ka bërë disa hapa në këtë drejtim - me sanksionet ndaj kompanive energjetike ruse, të cilat kanë pasur një efekt shumë pozitiv. Por, ka hequr dorë vullnetarisht nga disa leva të presionit. Për shembull, vendimi për të përjashtuar publikisht mundësinë e furnizimit të Ukrainës me raketa Tomahawk. Në rregull, nëse nuk duan t'i japin Ukrainës raketa Tomahawk, por pse të thuhet publikisht?! Ato mund të shërbejnë si leva, mund ta nxisin Putinin të mendojë se nëse kërkon shumë, SHBA-ja mund të shkojë më larg me mbështetjen e Ukrainës.

Ju, po ashtu, argumentoni se anëtarësimi i Serbisë në NATO do

të mund të ishte një përparim strategjik për Ukrainën. Sa realist është ky skenar, duke pasur parasysh politikën e brendshme të Serbisë dhe ndjenjat e forta proruse?
Edward P. Joseph: Kjo do të ishte një presion shtesë mbi Putinin. Sipas mendimit tim, do të ishte e barazvlefshme me fundosjen e "Moskva"-s - anijes luftarake ruse që Ukraina e fundosi me dronë. Anëtarësimi i Serbisë në NATO do të ishte ekuivalenti ballkanik i fundosjes së "Moskva"-s. Pse? Sepse Serbia është "Moskva" e Rusisë në Ballkan. Serbia është anija luftarake përmes së cilës Rusia projektton ndikimin e saj në të gjithë Ballkanin. Nëse ajo anije mbytet, ose nëse lundron drejt ujërave të NATO-s, kjo do të ishte një goditje e madhe për Rusinë - edhe për Kinën - sepse si Rusia, ashtu edhe Kina, formalisht dhe metaforikisht, e shohin Serbinë si partneren e tyre strategjike dhe platformën kryesore të ndikimit në Ballkan. Tani vjen pyetja juaj shumë e vlefshme: pse do ta bënte Serbia këtë, duke pasur gjithë atë simpati për Rusinë? Ka disa arsye - dhe madje një arsye që do ta bënte pothuajse të pamundur për [presidentin serb, Aleksandar] Vuçiq që ta refuzonte një ofertë të tillë nga Trump. Së pari, Trump është jashtëzakonisht popullor në Serbi dhe është një figurë shumë imponuese. Për Vuçiqin do të ishte shumë e vështirë t'i thoshte:

'Jo, nuk pranoj'. Për më tepër, Trump, gjatë mandatit të tij të parë, u përpoq të sillte paqe mes Kosovës dhe Serbisë - pra, kjo nuk do të ishte diçka e re. Ai e njeht rajonin dhe shpesh thotë se 'ndaloj një luftë mes Serbisë dhe Kosovës'. Së dyti, Vuçiq është i dobësuar politikisht. Protestat antiqeveritare në Serbi vazhdojnë prej një viti, dhe ai është aq i pasigurt sa nuk guxon të shpallë zgjedhje të reja - gjë të cilën e ka bërë shpesh më parë. Pranimi i një plani të tillë do ta ndryshonte tërësisht situatën e brendshme politike. Protestat nuk do të ishin më në qendër; vëmendja do të kalonte te ky zhvillim historik. Sigurisht, shumë proruse do ta quanin tradhtar. Por, pjesë të mëdha të opozitës do ta mbështesnin, sepse anëtarësimi në NATO nënkupton më shumë reforma, përparim drejt BE-së dhe fund të politikës së 'dy karrigeve'.

Por, përtej popullaritetit të Trumpit në Serbi, cilët faktorë strukturorë ose politikë e bëjnë këtë skenar të realizueshëm?
Edward P. Joseph: Është plotësisht e realizueshme, sepse zgjerimi i NATO-s në Ballkan nuk u kushton asgjë Shteteve të Bashkuara. Nuk ka kërcënime në Ballkan që NATO-ja nuk mund t'i trajtojë, ose që nuk mund t'i parandalojë vetëm me praninë e saj. Pra, nuk ka asnjë rrezik për SHBA-në.

Ballkani tashmë është i rrethuar nga vende anëtare të NATO-s. Tri nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë në NATO. Serbia është i vetmi shtet në rajon që thotë se nuk dëshiron të anëtarësohet. Edhe Bosnje e Hercegovina ka dëshirë formale të hyjë në NATO, ndërsa Kosova, sigurisht, e dëshiron shumë anëtarësimin. Pra, Serbia është e vetmuar në këtë kuptim. Ajo është e rrethuar nga Bullgaria, Rumania, Kroacia, Mali i Zi - të gjitha këto vende në NATO. Për më tepër, Serbia ka marrëdhënie të mira me NATO-n. Ka pasur takime me [shefin e NATO-s] Mark Rutte dhe [me ish-shefin Jens] Stoltenberg. Serbët, po ashtu, e mbështesin misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR. Ata nuk thonë se 'KFOR-i është forcë okupimi, duhet të largohet'; përkundrazi, në Beograd shpesh kërkojnë që KFOR-i t'i shtojë trupat. Serbia ka marrëdhënie të mira edhe me ushtrinë amerikane dhe me komandën e NATO-s. Nëse do t'i pyesje privatisht gjeneralët serbë, shumica do të dëshironin anëtarësimin në NATO, sepse kjo do të fuqizonte industrinë e armëve dhe municioneve në Serbi. Presidenti Trump, përveç ofrimit të rrugës për anëtarësimin e Serbisë në NATO, do të ofronte një rrugë drejt NATO-s edhe për Kosovën. Kjo do të nënkuptonte që kryeministri i Kosovës do të

duhej të nënshkruante statutin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe - jo thjesht ta dërgonte në Gjykatën Kushtetuese. Vuçiq e kërkon këtë asociacion prej vitesh dhe do ta fitonte atë.

Por, janë katër vende të NATO-s që nuk e njohin ende Kosovën - Greqia, Rumania, Sllovakia, Spanja...
Edward P. Joseph: Së pari, në këtë pikë, flasim vetëm për një rrugë drejt anëtarësimit në NATO, kështu që ato nuk kanë nevojë ta njohin Kosovën - asnjë nga katër vendet mosnjohëse nuk ka nevojë ta ndryshojë qëndrimin. Spanja mund të vazhdojë të mos e njohë Kosovën, nuk ka problem. Gjithçka që kërkohet është që të mos pengohet qasja eventuale e propozuar. Së dyti, Greqia, sapo kryeministri i Kosovës ta nënshkruajë statutin për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, jam i sigurt se do ta njihje Kosovën, pavarësisht nëse Serbia e pranon ose jo. Pasi Greqia ta njohë Kosovën, do të bëhet më e lehtë për Rumaninë, Sllovinë dhe Spanjën të ecin në po të njëjtën rrugë. Por, prej tyre nuk kërkohet ta njohin menjëherë Kosovën, vetëm të mos e pengojnë antarësimin në NATO. Brenda tre vjetësh ndoshta, situata do të jetë krejtësisht ndryshe. Tensionet do të ulen, do të ketë më shumë tregti dhe më shumë marrëdhënie.

CAKOLLI THOTË SE VOTIMI VETËM NË PËRFAQËSI DIPLOMATIKE FORCON INTEGRITETIN ZGJEDHOR

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se vendimi i fundit i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në lidhje me votimin e diasporës është një pikë kthese e rëndësishme për integritetin e zgjedhjeve të 28 dhjetorit. Cakolli ka thënë se vendimi që votimi të bëhet vetëm në përfaqësitë diplomatike ose në hapësirat e tyre është i rëndësishëm. "Vendimi i fundit i PZAP-së nuk është vetëm një korrigjim teknik i KQZ-së. Është një pikë kthese e rëndësishme për integritetin e zgjedhjeve të 28 dhjetorit. Ky vendim rivendos një standard të qartë ligjor dhe, duke besuar që do të konfirmohet edhe nga Gjykata Supreme nëse



dërgohet si rast, mbyll çdo dilemë për mënyrën e organizimit të votimit jashtë Kosovës. Por po aq e rëndësishme është që PZAP-ja i ndaloj përpjekjet për krijimin e

një situatë të paqenë, për ta paraqitur diasporën si të 'penguar' nga votimi. Në fakt, as PZAP-ja, as parashtruesit e ankesës dhe askush tjetër nuk e

ka 'ndaluar diasporën'. Thjesht, nuk u lejua shkëlja të ligjit në emër të narrativave politike dhe 'kauzave; elektorale, si dhe u neutralizua një lojë që rrezikon ta deformojë debatin publik rreth diasporës", ka shkruar ai në "Facebook". Cakolli ka theksuar se ironia më e madhe është se ata që kontribuuan maksimalisht që data e zgjedhjeve të jetë 28 dhjetori, pikërisht me arsyetimin se "diaspora do të jetë këtu". "Tani po thonë se as përfaqësitë diplomatike nuk mjaftojnë. Tash kërkuar qendra shtesë, kryesisht në hapësira private, në restaurante e në ambiente fetare... jo sepse janë të nevojshme, por sepse ndihmojnë narrativën. Për më tepër, as në zgjedhjet e 9 shkurtit, që ishin të rregullta dhe me afate dukshëm më të gjata, pothuajse asnjë

qendër jashtë vendit nuk e arriti kapacitetin maksimal të votuesve që mund të regjistroheshin. Pra, nuk ka pasur kërkesë që i tejkalon kapacitetet ekzistuese. Prandaj, sot është një ditë e mirë për demokracinë dhe integritetin zgjedhor në Kosovë. Edhe nëse ditët në vijim do të mund të dëgjojmë sërish se 'dikush ua paska ndaluar diasporës votimin' faktet janë të thjeshta, por jashtëzakonisht kokëforta. Mjafton të lexohet vendimi i PZAP-së, dhe kuptohet menjëherë se kjo është një tezë e zbrazët dhe strategji e vjetër për mobilizim elektorale. Diaspora nuk duhet të bjerë pre e diskurseve përçarëse. Ajo do të votojë, ashtu siç e përcakton ligji. Kjo është mënyra më e sigurt që vota e çdo qytetari jashtë vendit të ketë vlerë dhe legjitimitet të plotë", ka thënë Cakolli.

Aprovohen mbi 14 mijë aplikime për votim jashtë Kosovës

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se mes datës 26 nëntor dhe 30 nëntor përmes platformës elektronike të KQZ-së janë pranuar rreth 24 500 aplikime për votim jashtë Kosovës. Mbi 14 600 aplikime janë aprovuar, ndërsa rreth 3

500 janë refuzuar. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka theksuar se në bazë të numrit të përgjithshëm, shumica janë regjistruar për të votuar përmes postës, duke dërguar fletëvotimin në një prej kutive postare jashtë Kosovës ose në kutinë postare të KQZ-së

në Kosovë. "Mbi 10 500 prej tyre për të dërguar pakon me fletëvotim në ndonjërin nga adresat e kutive postare jashtë Kosovës dhe mbi 500 të tjerë për të dërguar pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë. Ndërkaq, mbi 3 500 shtetas janë regjistruar për të

votuar fizikisht në ndonjërin nga përfaqësitë diplomatike", ka deklaruar Elezi. Një element duhet ta kenë parasysh qytetarët që vendosin ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës: ata që regjistrohen për votim jashtë vendbanimit të tyre në Kosovë nuk do të mund



të votojnë fizikisht në vendlindje në ditën e zgjedhjeve.

TË POSHTËR DHE TË PAFYTYRË!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Festa e horrave: Për Festën e Flamurit Kombëtar u organizuan shumë aktivitete, në Shqipëri ku është edhe vendlindja e kësaj feste dhe gjithkund ku jetojnë shqiptarët. Që nga viti 1912 kur u shpallë pavarësia në Vlorë kjo datë dhe kjo ditë shënohet di dita më e rëndësishme e shqiptarëve. Nuk ka ndjenjë më të fuqishme dhe nuk ka sakrificë që nuk ia ka vlejtur në të kaluarën të bëhet për shënimin e kësaj dite...me një dëshirë dhe me një qëllim. Po në Kosovë, si u festua Dita e Flamurit? Ishte festa e horrave dhe u festua nga horrat. Të shkojmë radhazi:

1. Prekazi është kryeqyteti i luftës për liri dhe pavarësi të Kosovës. Për çdo patriot, për çdo ish të burgosur politikë, për çdo luftëtar të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, për çdo sakrifikues për çështje kombëtare, për çdo ninullë lirie, për çdo tregim trimërie, për çdo lot nëne..! Thjesht, Prekazi ishte vendlindja kombëtare, ushtarake dhe vendflijimi i Komandantit Legjendar Adem Jashari bashkë me bashkëluftëtarë, të moshuar, ushtarë, gra dhe fëmijë, disa shekuj të përmbledhur që u sakrifikuan për tre ditë. Prekazi ishte orakulli i frymëzimit dhe edukimit kombëtar me ligjëruesin e përjetshëm, kuptimin dhe përmbajtjen e luftës për liri dhe bashkim kombëtar Bacë Adem Demaçi. Një Adem e krijoi botën dhe njerëzimin, dy ADEMA i dhanë kuptim luftës

për liri dhe sakrificës. Hekuran parmilitari, Zdravo Mimoza, Besnik Rrenc Bislimi, Dimal Arsovska, Rozeta Mielli dhe mbetje tjera antikombëtare ishin në një foto “familjare” para vendprehjes së amshueshme të Komandantit Legjendar Adem Jashari. Shiheni me kujdes këtë foto dhe gjeni çfarëdo ndërlihdje me luftën e UÇK-së apo çështjen kombëtare, personalisht apo familjarisht! Nuk e gjeni edhe nëse ktheheni deri të koha e Skënderbeut. Përveç se mund të gjeni urryes të UÇK-së, denoncues dhe sabotues të luftës dhe zgjatim biologjik të udbashëve jugosllavë dhe serbë.

2. Në Shkodrën e Oso Kukës dhe Shtatë Shaljanëve, në emër të patriotizmit shkuan: presidentja personale e Albin Kurthit dhe Mjerani i Parë. Sikur të ishin pasardhës të Agronit dhe Teutës e jo përfitues të çastit që asgjë nuk kanë me çështjen kombëtare. Mjerani i Parë kishte vendosur plisin sikur ta kishte amanet nga Marash Cali. Çfarë ordineri!

3. Në Lezhë, Dimal Arsovska bëri përtpjekje, si Gjykata Speciale Raciste ta rishkruaj historinë e shqiptarëve dhe Shqipërisë, tha se Skënderbeu e ka ngritë flamurin në Lezhë. Nëse e kemi parasysh përçaktimin e tij politik dhe kombëtar, si alter ego e Arsovskës, nuk isha befashuar edhe po të thoshte se Goce Delçevi e ka ngritë flamurin kombëtar. Ky kokërr injoranti! Dhe 4. Në vendlindjen e

pavarësisë së Shqipërisë dhe tokës së shenjt të shqiptarëve ishte trojka e VV-së, kinse për ta festuar Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë në kohën kur marrëdhëniet i kanë më të mira me Serbinë se me Shqipërinë. Lenka Haxhiu dhe Donika Shvarc paradoksalisht kishin kostume kuq e zi ndërkaq dezertori i ndyrë i luftës e që sigurisht e ka edhe statusin e veteranit të luftës ishte veshur me një mantel si agjentët e sigurimit të shteteve komuniste. Asnjëri prej tyre nuk kanë asnjë kontribut kombëtar përveç se kombëtarizmin e kanë të trashëguar nga paraardhësit biologjik. Këtu përfundon patriotizmi i tyre.

Trashëgiminë kombëtare e kanë përdorur dhe keqpërdorur për pushtet, për asgjë tjetër! Me ta ishte edhe nëna greke e VV-së por, pasi në Shqipëri nuk ka vend as për nevoja fiziologjike, ka shkuar te babai i saj politik Fredi Belerisë për ta qëndisur flamurin e Vorio Epirit në Himarë. Kjo patriotë e VV-së! Albin Kurthi iku nga Kosova gjatë festës dhe shkoi në Maltë në takimin e Internacionales socialiste. Kështu e bënë ky bashkimin kombëtar. Mashtruesi!

Prej këtyre emrave që i përmenda, ma gjeni dikën që ka kontribuar për lirinë e Kosovës përveç se e kanë dëmtuar Kosovën, Shqipërinë dhe trojet shqiptare duke ndarë e përçarë shqiptarët si askush para tyre.

Albin Kurthi ka qenë i vetmi politikan që pas përfundimit të

luftës, pa u penguar nga askush (nuk kishte opozitë) të bëjë gjëra të mira për Kosovën dhe Shqiptarët. Asgjë nuk bëri mirë! Mitrovicën e Veriut nuk e çliroi (ishte çliruar në vitin 1999), nuk e futi nën sovranitet. Me marrëveshjen antikombëtare dhe antishtetërore të Brukselit dhe Ohrit, si vlerë të shtuar të Asociacionit e futi edhe vetëmenaxhimin, Rezolutën 1244 dhe Arbitrazhin. Vetëm i çmenduri mund ta bëjë këtë! Faktikisht e ka federalizuar Kosovën ku serbët fitojnë autonomi territoriale dhe politike. Tash ndërkombëtarët nuk po e kërkojnë vetëm Asociacionin por më shumë e kërkojnë Vetmenaxhimin. Kjo do të qëndrojë si shpata e Demokleut mbi qafën e çdo qeverie dhe çdo gjë do të kushtëzohet me te. Kurthi po mundohet të mobilizojë votuesit me “armiçësi” ndaj Listës Serbe të cilën në fakt e kanë pasur dhe e kanë partnerin më të besueshëm në çastet më të rënda dhe delikate për regjimin autokrat të Kurthit. Kujtojeni si u zgjodh presidentë personale e Kurthit Vojsa Osmani me ndihmën bujare të Listës Serbe. Apo, si u bllokuan ligjet kundër veteranëve të luftës nga trojka vëllazërore Radojiçiq - Simiq dhe Mimoza Kusari, seksere personale e Kurthit në këto allishverishe antikombëtare. Përdorimi i Listës Serbe kundër opozitës për zgjedhje të 28 dhjetorit është pordhë e ftohtë e Kurthit. Qendër e kësaj lufte është KQZ-ja që udhëhiqet nga Picimul Radonçiqi e që emrin

konspirativ e paska Kreshnik. Merreni me mend kur nuk ka guxim as të pëshurret pa fermanin e “skifterëve” të VV-së. Si zot shtëpie nuk ka guxim të marrë në mbrojtje anëtarët që po i dhunohen. Pranoi që edhe restorantet, kafenetë, shtëpitë publike dhe pufët sikur edhe objektet fetare të bëhen vendvotime jashtë vendit në kohën kur ambasadat dhe përfaqësitë konsulare janë shndërruar në qendra të prostitucionit diplomatik. Çdonjëri që nuk pranon të bëhet pjesë e orgjive diplomatike të pushtetit, largohet. Ose bëheni prostitutë e regjimit, ose nëse mbron parime dhe integritet njerëzor, profesional dhe moral, si Vehbi Miftari në Vatikan, i bëni gati valixhet.

Kush do të besonte se 26 vite pas përfundimit të luftës, ata që e bënë luftën, e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë, e krijuan shtetin dhe e afirmuan në skenën ndërkombëtare do të përballen me një proces të kriminalizuar të “drejtësisë ndërkombëtare”, të përkrahur nga pushteti aktual, festën e Shenjt për shqiptarët do ta presin në Burgun e Hagës duke u provokuar edhe më 28 Nëntor nga kriminelët ndërkombëtar dhe bashibozukët e tyre në Prishtinë që nuk lanë vend të shenjt pa përdhosur, në Prekaz, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë!

A keni dëgjuar që dikush e përmendi Bacë Adem Demaçin për 28 Nëntor?! Jo, madje as “nxënësi i tij politik, Albin Kurthi ...”!

Të pafytyrë dhe të poshtër!

Drejtoresha e Statistikave të Suedisë viziton ASK-në, diskutohet për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) më 27 dhe 28 nëntor 2025 priti për vizitë zyrtare drejtoreshën e përgjithshme të Statistikave të Suedisë (SCB), Eva-Lo Ighe, shoqëruar nga ekipi i saj. Statistikat e Suedisë (SCB) në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) kanë qenë ndër mbështetësit

kryesorë të ASK-së që nga viti 2001. Gjatë kësaj periudhe, ASK-ja ka përfutur përvojë dhe ekspertizë në fusha të ndryshme profesionale, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e proceseve statistikore në vend. Bashkëpunimi ASK-SCB/Sida synon harmonizimin e metodologjive statistikore me

standardet e Eurostat-it dhe avancimin e integritetit të statistikave të Kosovës në Sistemin Statistikor Evropian (ESS).

Të dyja palët vlerësuan lart rezultatet e arritura deri më sot, duke theksuar se përvoja e ndarë ka sjellë përfitime të rëndësishme dhe ka forcuar kapacitetet profesionale të ASK-së.

Gjatë takimeve u diskutuan komponentët kryesorë të projektit aktual SCB-Sida, progresi i arritur dhe fushat me prioritet për bashkëpunim të ardhshëm.

Palët shprehën gatishmërinë për të vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin në përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të statistikave zyrtare të Kosovës.



OEK-u i JEP ZRRE-së PESË DITË AFAT: ZBATONI VENDIMIN E SUPREMES OSE DO TË DORËZOJMË KALLËZIM PENAL

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka reaguar ashpër ndaj Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke e akuzuar për keqinterpretim të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lëndën P. A. nr. 18/2025 dhe duke paralajmëruar kallëzim penal ndaj kryetarit të Bordit të këtij institucioni, nëse vendimi nuk zbatohet brenda pesë ditësh. Në njoftimin e saj, OEK thekson se Gjykata Supreme ka konfirmuar se procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike është zbatuar në kundërshtim me ligjin, pa analizë konkurrence, pa konsultime publike dhe jashtë kompetencave ligjore të rregullatorit. Sipas OEK-ut, vendimi i Supremes është “i formës së prerë, i pakontestueshëm dhe i detyrueshëm për zbatim të

menjëhershëm”.

Oda kritikon ashpër komunikatën e ZRRE-së të datës 18 nëntor, duke e cilësuar si tentim për ta “relativizuar këtë vendim, duke krijuar pasiguri të re ligjore dhe duke ekspozuar bizneset ndaj rreziqeve ekonomike dhe dëmeve të mëtejshme”.

Në reagim thuhet se: “Vendimi i Gjykatës Supreme është i detyrueshëm për zbatim nga çdo institucion publik. Asnjë organ administrativ nuk mund ta interpretojë ose ta zbehtë efektin juridik të këtij vendimi. Çdo veprim i bazuar në aktet e shfuqizuara bie ndesh me rendin juridik të Republikës së Kosovës”. Sipas OEK-ut, bizneset janë dëmtuar rëndë nga procesi i liberalizimit që tashmë është konfirmuar si i paligjshëm, duke u përballur me rritje çmimesh, kontrata të imponuara dhe



depozita të pajustificuara.

OEK kërkon nga ZRRE që brenda pesë ditësh kalendarikë t'i ndër marrë hapat e detyrueshëm. “Të publikojë një komunikatë të re dhe të korrigjuar mbi vendimin e Gjykatës Supreme, të ndalojë çdo interpretim të pasaktë të vendimit, të rikthejë bizneset e prekura në Shërbimin Universal, të rillogarisë faturat e periudhës

së liberalizimit të paligjshëm dhe të zbatojë në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme”, thuhet në njoftim.

Nëse këto veprime nuk ndërmerren brenda afatit, OEK paralajmëron se do të dorëzojë kallëzim penal ndaj kryetarit të Bordit të ZRRE-së si përgjegjës për pengimin e zbatimit të një vendimi të formës së prerë.

Sipas njoftimit, moszbatimi i vendimit dëmton rëndë konkurrueshmërinë e bizneseve vendore, besueshmërinë e investitorëve, stabilitetin ekonomik, sigurinë juridike në sektorin energjetik dhe imazhin e vendit si destinacion për investime.

OEK shton se procesi i paligjshëm ka “krijuar kosto të larta operative, ka cenuar planifikimin financiar dhe ka pamundësuar investime të reja, duke rrezikuar mijëra vende pune”. Në fund të njoftimit, OEK garanton se do të vazhdojë mbrojtjen juridike të bizneseve të prekura dhe se nuk do të lejojë që vendimet e formës së prerë të injorohen. “Shteti ligjor funksionon vetëm kur vendimet e gjykatave zbatohen. Asnjë institucion nuk mund të qëndrojë mbi ligjin”, përfundon njoftimi i OEK-ut.

KEDS-i FILLOI DYFISHIMIN E KAPACITETIT TË RRJETIT NË MALISHEVË

MALISHEVË, 1 DHJETOR - KEDS-i ka njoftuar se në Malishevë ka filluar një prej fazave më të rëndësishme të modernizimit të rrjetit elektrik: konvertimin e linjave të tensionit të mesëm nga 10 kV në 20 kV. Sipas KEDS-it, ky proces dyfishon kapacitetet bartëse të rrjetit dhe përbën avancim të madh teknik që pritet ta rrisë ndjeshëm cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me energji elektrike për të gjithë komunën. “Ky investim është pjesë e planit afatgjatë të kompanisë për modernizimin e rrjetit elektrik në mbarë vendin. Ky hap i ri ndërtohet mbi projektet strategjike të kryera gjatë viteve të fundit. Vitin e kaluar, KEDS ka instaluar superpërçuesin në linjën 35 kV Rahovec-Malishevë, duke rritur ndjeshëm kapacitetin e transmetimit dhe stabilitetin e



rrjetit rajonal. Investimi i tanishëm në 20 kV e çon Malishevën në nivel të ri teknik, duke e bërë rrjetin lokal dukshëm më të fortë dhe më të qëndrueshëm. Megjithatë, duhet theksuar se kapaciteti i përgjithshëm i furnizimit në Malishevë varet drejtpërdrejt edhe

nga infrastruktura e KOSTT-it, konkretisht nga Nenstacioni i ri 110/35/10 kV Malishevë, i cili ende nuk është përfunduar. Derisa ky nënstacion të hyjë në operim, burimi kryesor furnizues i Malishevës mbetet i kufizuar”, ka njoftuar KEDS-i.

Para investimit të KEDS-it në

linjën e re 35 kV (me ACCC), Malisheva ishte e kufizuar në rreth 20 MW furnizim. “Gjatë dimrit të kaluar, ngarkesa arriti në 35 MW, duke treguar qartë se zona tashmë është afër kufijve teknikë të kësaj linje të re. Gjithashtu, gjatë këtij viti, numri i Pëlqimeve Elektroenergjetike dhe konsumatorëve të rinj është rritur dukshëm, duke gjeneruar presion shtesë në rrjet, sidomos gjatë sezonit të dimrit kur kërkesa rritet në mënyrë të konsiderueshme. Pra, Malisheva ka arritur kapacitetin maksimal të mundshëm të strehimit nga ana e KEDS-it pa investimet shtesë nga KOSTT-i. Si Operator i Shpërndarjes, KEDS ka kryer të gjitha përmirësimet e mundshme në rrjetin e tensionit të lartë dhe të mesëm, përfshirë këtë fazë finale

të konvertimit në 20 kV, e cila ofron rritje të kapaciteteve. Por për shkak të rritjes së shpejtë të konsumit në Malishevë, asnjë operator nuk mund të garantojë furnizim të pakufizuar derisa të përfundojë Nenstacioni i ri i KOSTT-it. Sa iu përket raportimeve në disa media dhe pretendimeve të disa banorëve, KEDS sqaron se furnizimi në Malishevë është stabil dhe nuk ka probleme të përgjithshme. Çështja e raportuar lidhet me tre blloqe të reja banesore, ku investitori nuk ka përfunduar punimet e brendshme teknike sipas standardeve të parapara, duke shkaktuar mbingarkesa të lokalizuara dhe shpërthim të siguresave. Situata është e izoluar dhe nuk ka lidhje me rrjetin e Malishevës në tërësi”, ka njoftuar KEDS-i.

Murati: Mbi 11 mijë ndërmarrje të regjistruara deri më tani

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në Kosovë tashmë ka kaluar shifrën prej 11 mijë deri në

fund të muajit tetor. Sipas Muratit, në bazë të trendit aktual deri në fund të vitit kjo shifër pritet të tejkalojë 13 mijë biznese, duke vendosur një rekord të të gjitha kohëve në vend. “Numri i

ndërmarrjeve të reja të regjistruara tashmë ka kaluar shifrën prej 11 mijë deri në fund të muajit tetor, ende pa mbaruar viti. Sipas trendit aktual, deri në fund të vitit kjo shifër pritet të

tejkalojë mbi 13 mijë biznese, që do të ishte rekord i të gjitha kohëve. Ky është tregues i shëndetit të mirë të ekonomisë e cila po rritet vazhdimisht”, ka shkruar Murati në “Facebook”.



MUZEU POETIK I DHIMBJES SHQIPTARE

(Poezia antologjike nuk shkruhet, ajo ndodh si një tronditje e heshtur që ta zgjatë jetën edhe kur s'të mban më shpirti.).
SHËNIME RRETH VEPRËS POETIKE “ËNDËRR NË ZARF” TË ISMAIL SYLËS, BOTUAR NGA “ARTINI”, PRISHTINË, 2025

Prof. Dr. Ragip GJOSHI


Krijuesi letrar, poeti, eseisti dhe publicisti i njohur Ismail Syla në dhjetë përmbledhjet e tij me poezi, ka ndërtuar me sistem universin poetik për tri profilet e atdheut të tij, individuale dhe historike: Atdheun e Pabërë, Atdheun Depresiv dhe Atdheun Heroik. Ai, po ashtu ka estetizuar me sistem në krijimet e shkurtra - në epe - qindra frazeologji antologjike të gjuhës shqipe, fjalë të urta, duke vënë në funksion madje edhe fjalorin e heshtur të estetikës së Kanunit të Lekë Dukagjinit. Përmes figurës mitologjike të Sfinksit, Ismail Syla në çdo përmbledhje ka ngritur dilemat ekzistenciale dhe filozofike që e mundojnë atë dhe njeriun e botës moderne. Në këtë fundvit për lexuesin e tij Ismail Syla pas veprës “Leximi eseistik” (ese letrare, filozofike dhe kulturologjike) në gjeografinë e krijimtarisë poetike solli edhe përmbledhjen poetike “Ëndërr në zarf”. Kështu, poeti i mirënjohur Syla rishfaqet me një prej veprave më të plota poetike të letërsisë shqipe bashkëkohore, një libër ku poezia ndodh si përjetim i thellë dhe jo veç si këngëtim artistik. Vëllimi ndërtohet si kronikë emocionale, si poemë e gjatë dhe si një ditar i intimitetit shpirtëror, duke e kthyer fjalën në një organ të brendshëm të kujtesës. Brenda 154 poezive të strukturuar në katër kapituj, poeti modelon një univers ku tri boshtet e poezisë moderne - përjetimi, subjektiviteti i zhveshur dhe metafora organike - krijojnë një topografi të ndjenjave, ku çdo varg funksionon si stacion i një udhëtimi të brendshëm.

Struktura e librit - një dramaturgji e dhimbjes

Libri “Ëndërr në zarf” ndërton një univers poetik dhe narrativ ku ndërthuren dhimbja historike, reflektimet shpirtërore, kujtesa kolektive dhe dimensionin njerëzor i tragjedive të luftës. Struktura lëviz mes dy boshtesh: dokumentimit realist dhe diskutit poetik simbolik. Kjo dyfishësi i jep tekstit thellësi estetike dhe peshë emocionale. Vepra është e ndarë në katër tufë-kapituj kryesorë që funksionojnë si katër akte të një drame kolektive: “Plagë që bari s’i mbulon”, “Kova – histori në katër akte”, “Nën thundrën e krimit” që përmban gjashtë nëncikle: Monologë dhembjesh, Plagë lufte, Të vetmuarit, Të braktisurat, Pa frymë njeriu dhe Artefakte dhembjesh dhe kreu i fundit “Duart që bien erë dhe”.

Plagë që bari s’i mbulon

Kapitulli i parë është themeli i dhembjes faktike. Poezitë shfaqin pamjet e zhdukjes, kërkimit, gërmimit dhe identifikimit. Bunarët, thasët me rroba, lodrat e fëmijëve, dhomat, shamitë – të gjitha janë të shndërruara në simbolika të heshtura të krimit.



Poeti nuk poetizon tmerrin; e regjistron atë me saktësi dokumentare, duke e bërë lexuesin të hyjë në brendinë e traumës pa ndërmjetës. Ky kapitull sjell rrëfime të humbjeve njerëzore, varreve të hapura, bunarëve të fshehur dhe trupave të zhdukur. Dhimbja personale përziehet me heshtjen kolektive, duke krijuar një atmosferë të rëndë dhe të pambaruar. Tema kryesore të prologut të librit janë: humbja dhe trauma familjare, kujtesa e dhimbjes së papërfunduar, dhe heshtja si barrë e si dëshmi. Figurshmëria e vargjeve ndërthuret me metafora si “lodra në fund të pusit”, “hëna që sheh”, “guri që mungon” shënjojnë mungesën, të fshehtën dhe dhimbjen e heshtur. Ndërsa, personazhet e vargut janë nënat, fëmijët, familjarët e heshtur; ndërkohë vetë bunari dhe varri shndërrohen në “personazhe” që mbajnë kujtesën.

Kova - histori në katër akte

Ky kapitull është nga më origjinalët: një mikro-dramaturgji në katër akte – para luftës, gjatë luftës, te bunari, në muze. Kova, një objekt i zakonshëm, bëhet personazh i tragjedisë, duke kaluar nga funksioni praktik te funksioni muzeal. Ky transformim e bën objektin dëshmitar më të besueshëm se fjala e njeriut. Kjo pjesë vërteton se edhe poezia mund të ketë logjikë teatrore dhe muzeale njëkohësisht. Kjo pjesë e librit është një narracion i strukturuar si dramaturgji, që ndjek jetën para, gjatë dhe pas tragjedive të luftës. Ndërsa tematike e vargjeve është, krimi dhe mungesa e drejtësisë, jeta e ndërprerë dhe fashitja e normalitetit. Poeti në këtë kapitull për stil përdor monologë, dialogë të shkurtër dhe tension dramatik.

Nën thundrën e krimit

Kjo pjesë e vjen si kapitulli më i gjerë dhe më polifonik. Ai përmban gjashtë nënndarje, ku flasin zëra, objekte, njerëz të mbetur, hapësira dhe gjurmë. Poezitë janë të shkurtra, por të pasura në nëntekst: “Dhoma që nuk lëshon frymën”, “Zarfi pa adresë”, “Vëllai i tretur”, “Kutia e këpucëve”, “Dora në hi”. Këtu dhimbja nuk vjen vetëm nga fakti, por nga ajo që ka mbetur pas faktit – heshtja, vetmia, boshllëku i shtëpisë, pluhuri i gurtë i

mungesës. Autori e ndërton këtë kapitull si një mozaik të fragmentarizuar, ku çdo copëz është një dritare në tragjedinë e papërcillshme. Ky kapitull përqendrohet te pasojat e brendshme të traumës – izolimi, frakturat morale dhe heshtja. Motivet kryesore që dalin në sfond janë: vetmia dhe pafuqia, heshtja që fsheh të vërtetën dhe dhoma dhe objekti si dëshmi të mungesës. Figurshmërinë e përbëjnë objekte të thjeshta – çorapja e vetme, dhoma pa dritare, sendet e braktisura – bëhen simbole të humbjes dhe plasaritjes së jetës së mëparshme.

Duart që bien erë dhe

Skajet emocionale të veprës përmbahen në segmentin dokumentar-poetik për tragjedinë e familjes së Imer Deliut. Kjo është ndër pjesët më të fuqishme të gjithë strukturës. Gjuha këtu bëhet e thyer, e shkurtër, e ndërprerë-si një kujtim që s’gjen dot formë të plotë. Përdorimi i emrave (Hamide, Ademi, Jetoni, Lumnije, Diturina, Gentiana, Valmiri, Mendehija e të tjerë) e çon tekstin nga abstraktja te konkretja, duke e kthyer secilin emër në simbol të pafajësisë së prerë në mes. Figuracioni poetik – “dorën e ngrirë përpjetë”, “kraharror i shpuar”, “flakët në strehët e shtëpisë”, “rrugët e heshtura që lamë bashkë” - krijojnë një galeri imazhesh që shkundin lexuesin dhe e futin në zemër të tragjedisë. Alternimi mes rrëfimit faktik dhe vargjeve simbolike e thellon dimensionin etik dhe emocional të tekstit: dokumenti dëshmon, poezia përjetëson. Kapitulli final i ngjan një liturgjie përkujtimore. Emrat konkretë të viktimave - Hamide, Adem, Jeton, Lumnije, Valmir, etj. - kthehen në qendër të veprës, duke i dhënë librit dimensionin më njerëzor. Poezitë janë të shkruara si portrete të shkurtra, si epitafe që munguan në realitet. Përmes tyre, poeti kryen një akt drejtësie simbolike, duke ua kthyer viktimave atë që iu mohua: identitetin e plotë. Pjesa e epilogut të librit është plot segmente reflektive, ku poeti radhit emra të viktimave dhe të dashurve si një ritual kujtese, duke i kthyer në një epilog të dhembjes kolektive. Në epiqendër është tematika me përkujtimin e të vdekurve, rikthimi i emrave në gojë si akt përjetësimi dhe emri si monument. Bie në sy stili i listimit

ritmik krijon një lloj liturgjie poetike. Struktura e librit përfundon në dhe, tek simboli final i rikthimit. Dheu nuk është veç tokë; është ruajtësi i së vërtetës dhe i kujtesës. Epilogu e mbyll librin me një thjeshtësi tronditëse, duke rikthyer lexuesin te heshtja – jo si mungesë, por si prani. Libri i radhës “Ëndërr në zarf” i Ismail Sylës është një nga përmbledhjet poetike më të realizuara tematikisht të shkruar rreth dhembjeve e traumës së luftës dhe zhdukjes së personave gjatë fundshekullit të kaluar në Kosovë. Ai nuk kërkon të shërojë plagën, por ta dokumentojë atë, duke i dhënë letërsisë një funksion etik dhe historisë një dimension emocional që shpesh mungon në dokumentet zyrtare. Në këtë kuptim, libri është një muze poetik, ku çdo poezi është një artefakt, çdo imazh një provë dhe çdo objekt një dëshmitar. Dimensionin emocional dhe historik i veprës duket si një memorial poetik i tragjedive të viteve 1998-1999, sidomos masakrave në Poplek dhe Abri, ku dhimbja personale lidhet me traumën e dhembjen kombëtare. Motivet kryesore emocionale janë: heshtja - si forcë dhe hapësirë e pushtuar nga mungesa, gjurmët - si dëshmi e fundit e jetës së shuar, uji dhe bunari - metafora të fshehtës dhe të pazbulesës dhe hijet - mbeturinat e kujtesës.

Tematika dhe motivet, stili - një atlas poetik i dhunës

Poezia e Sylës nuk e përshkruan traumën; ajo e konkretizon përmes sendeve që nuk gënjëjnë. Kurse, heshtja dhe fjala e pezulluar, nënteksti ndërtohet mbi boshësi, mungesë, ndërprerje. Fjala shpesh ndalet aty ku realiteti është i padurueshëm. Ndërkaq, dheu dhe uji vjen si fund i qarkut dhe uji si shuarje, si mungesë e trupit. Këto dy elemente krijojnë stabilitetin simbolik që mban librin. Stili i Ismail Sylës është i kontrolluar dhe i përmbajtur, i ndërtuar mbi disa karakteristika thelbësore. Stilistika që e shoqëron poetin është minimalizëm ekspresiv, sepse poezitë janë të shkurtra, të koncentruara, të zhveshura nga zbukurimet. Forca vjen nga konciziteti, nga prerja e vargut, nga fjala e kursyer. Ne stilin e autorit hetohet imazhi i pastër, fotografik ku ato dalin më shumë se metafora, dominon imazhi. Poeti ndërton vargun si kornizë, duke kujtuar estetikën e dokumentarit. “Kamera nuk e kap ngjyrën e vdekjes” është një shembull tipik i ironisë së dhimbshme vizuale. Në mjetet stilistike Syla përdor objektet-simbol, ku objektet nuk janë elemente dekorative, por qendra semantike: kova, zarfi, kutia e këpucëve, çanta e shkollës, shalli etj. Këto të kujtojnë teknikat e poezisë evropiane të traumës .Stilistikën e Sylës e ndjek polifonia e zërave .Libri flet me shumë zëra, por asnjëri nuk

bërtet. Zëri i nënës, i fëmijës, i vëllait, i shtëpisë, i dhomës, e ku të gjithë shfaqen si hije të buta, por të pandalshme. Kështu, etika e kujtesës së autorit nuk ngrihet në akuzë, nuk përdor patos, nuk e përdor dhimbjen për efekt estetik. Përkundrazi, ai ruan dinjitetin e viktimave duke shkruar me thjeshtësi, me respekt, me maturi. “Ëndërr në zarf” është një libër që e tejkalon kufirin e një botimi poetik dhe hyn në fushën e një dokumentari poetik të një arke të dëshmive. Forca e tij nuk qëndron vetëm në vargje, por në koncept, strukturë, ritëm dhe etikë. Libri ka koherencë të jashtëzakonshme: çdo poezi i përket tërësisë. Ka strukturë dramaturgjike që rrallë shihet në librat shqip. Ka thjeshtësi të ndritshme, e cila shndërrohet në intensitet emocional. Ka dëshmi pa retorikë, një nga cilësitë më të vështira të poezisë së traumës. Në një kohë kur letërsia shpesh largohet nga realiteti, Ismail Syla e risjellë poezinë në territorin e dëshmisë morale. Kjo e bën librin jo vetëm të vlefshëm eseistikë, por edhe të rëndësishëm në rrafshin social.

Përmbyllje

Të gjitha poezitë përbëjnë një arkiv dhimbjeje të përditshme, ku objektet e zakonshme bëhen dëshmitarë të humbjes, vuajtjes dhe përjetimit të kujtesës. Lidhja me ngjarjet e Poplekut është e dukshme: poezia shpreh atë që artikulli dokumentar tregon në formë faktuale - humbjen e jashtëzakonshme dhe dhimbjen e papërballueshme, por në mënyrë simbolike dhe emocionale. Libri “Ëndërr në zarf” shfaqet si një hulumtim i thellë i kujtesës, dhimbjes dhe përjetimeve ekzistenciale të subjektivitetit lirik. Titulli, i ndërtuar mbi dy figura kyçe, funksionon si metaforë hermeneutike: “ëndrra” tregon hapësirën intime të pavetëdijshme, ndërsa “zarfi” simbolizon enën e komunikimit të vonuar. Kjo metaforë arkivo-poetike sugjeron se kujtimet ruhen dhe çlirohen vetëm kur hapet kjo kohë e mbyllur, duke krijuar një dialog midis së kaluarës dhe së tashmes. Përmbledhtas, vepra është një ndërthurje e fuqishme mes poezisë dhe historisë, që e ngre tragjedinë individuale në nivel kolektiv, duke dëshmuar jo vetëm atë që ndodhi, por edhe mënyrën se si kujtohet, përjetohet dhe transmetohet dhimbja. Në këtë mënyrë, “Ëndërr në zarf” funksionon si monument letrar i humbjes, qëndrueshmërisë dhe humanitetit. “Ëndërr në zarf” është një nga librat më të strukturuar tematikisht për dhimbjen dhe traumën e luftës në poezinë shqipe të viteve të fundit. Veçohet për stilin e matur, strukturën dramaturgjike, përdorimin e artefakteve si figura poetike, etikën e lartë të kujtesës, aftësinë për të sjellë dhimbjen pa patetizëm. Libri është një rekuiem modern, një muze poetik, një akt drejtësie simbolike.

LAKU PO SHTRËNGOHET PËRRETH NICOLA MADUROS

Nafta, narkoterrorizmi dhe kalkulimet e fshehta të Uashingtonit: pse Maduro është bërë nyja e re e krizës globale. Çfarë fshihet pas lojës së trefishtë: goditja ndaj Maduros, lufta për naftën dhe betejat e brendshme në Washington

Sipas disa zyrtarëve amerikanë, administrata ka hartuar disa alternativa për një ndërhyrje ushtarake në Venezuelë, përfshirë edhe sulme të drejtpërdrejta kundër njësive që sigurojnë presidentin Nicolás Maduro, si dhe masa për të marrë nën kontroll vendburimet e naftës së vendit. Trump nuk ka marrë ende një vendim se si, ose nëse, do të veprojë. Zyrtarët theksojnë se ai nuk dëshiron të miratojë operacione që mund të rrezikojnë trupat amerikane ose të rezultojnë në një dështim të turpshëm.

Megjithatë, shumë prej këshilltarëve të tij po shtyjnë drejt njërit prej opsioneve më agresive: rrëzimit të Maduros. Ata i kanë kërkuar Departamentit të Drejtësisë udhëzime që të ofrojnë një bazë ligjore për veprime ushtarake që shkojnë përtej sulmeve ndaj anijeve të akuzuara nga Uashingtoni, pa prova, se janë të përfshira në trafikun e narkotikëve. Këto udhëzime mund të krijonin një kornizë ligjore që do t'i lejonte Shtetet e Bashkuara të goditnin Maduron, pa pasur nevojë për një autorizim të Kongresit për përdorimin e forcës ushtarake. Udhëzimet ligjore janë ende në fazë hartimi, por sipas disa zyrtarëve, argumenti që pritet të mbështetet është se Maduro dhe drejtuesit e aparatit të sigurisë janë figura qendrore të kartelit Los Soles, të cilin Shtetet e Bashkuara e klasifikojnë si grup narkoterrorist. Departamenti i Drejtësisë mund të konkludojë se ky kategorizim e bën presidentin venezuelan një objektiv legjitim, pavarësisht se ligji amerikan ndalon vrasjen e liderëve të vendeve të tjera. Departamenti i Drejtësisë ka refuzuar të komentojë. Përpjekja për të justifikuar një goditje kundër Maduros do të ishte një hap tjetër i administratës amerikane për të zgjeruar kompetencat e saj ligjore. Uashingtoni ka ndërmarrë tashmë vrasje të shënjestruara të personave të dyshuar si narkotrafikantë, të cilët deri në shtator zakonisht ndiqeshin penalisht dhe arrestoheshin në det, dhe nuk eliminoheshin me sulme dronësh. Çdo operacion që synon rrëzimin e Maduros do ta ekspozonte administratën ndaj një shqyrtimi edhe më të rreptë të bazave ligjore të veprimeve të saj, sidomos duke pasur parasysh arsyetimet e paqarta të përdorura deri tani: trafikun e drogës, interesin amerikan për naftën venezuelane, dhe

pretendimet e Trump-it se Maduro ka liruuar të burgosur, për t'i dërguar drejt kufijve të SHBA.

Trumpi ka dhënë një seri deklarata të ndërlukuara e shpesh kontradiktore lidhur me qëllimet, objektivat dhe legjitimitetin e mundshëm të një veprimi ushtarak. Ai ka njoftuar se sulmet kundër anijeve në Karaibe dhe në Paqësorin lindor, ku deri tani kanë humbur jetën më shumë se shtatëdhjetë persona, do të zgjeroheshin për të përfshirë edhe objektiva tokësorë. Por ky zgjerim ende nuk është bërë.

Më 3 nëntor, kur CBS News e pyeti nëse Shtetet e Bashkuara po shkonin drejt një lufte kundër Venezuelës, ai u përgjigj: "Nuk e besoj. Nuk mendoj, por na kanë trajtuar shumë keq, dhe jo vetëm për çështjen e drogës". Trumpi përsëriti akuzën e tij të pambështetuar se Maduro ka hapur burgjet dhe institucionet psikiatrike për të dërguar në SHBA persona të lidhur me bandën kriminale Tren de Aragua. Kur u pyet nëse ditët e Maduros në pushtet janë të numëruara, ai u përgjigj: "Besoj se po".

Presioni psikologjik

Ndër shtytësit kryesorë të opsioneve më agresive janë sekretari i Shtetit Marco Rubio, i cili shërben edhe si këshilltar i përkohshëm për sigurinë kombëtare, dhe Stephen Miller, zëvendës shef i stafit dhe këshilltar për sigurinë kombëtare. Rubio dhe Miller, në biseda private, argumentojnë se Maduro duhet detyruar të largohet nga pushteti. Sipas bashkëpunëtorëve të tij, Trumpi ka shprehur disa rezerva, pjesërisht nga frika se operacioni mund të dështojë. Presidenti nuk ka ngut për të marrë një vendim dhe ka kërkuar të dijë cilat do të ishin përfitimet konkrete për Shtetet e Bashkuara, duke u përqendruar sidomos tek mundësia që Uashingtoni të sigurojë një pjesë të naftës venezuelane. "Presidenti Trump i ka dërguar një mesazh të qartë Maduros: ndalo së dërguari drogë dhe kriminelë në vendin tonë", tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Anna Kelly. "Presidenti ka qenë i qartë se do të vazhdojë të godasë narkoterroristët e përfshirë në trafikun e drogës. Çdo gjë tjetër është spekulim dhe duhet trajtuar si i tillë". Pritet që Trumpi të marrë një vendim pas mbërritjes më 11 nëntor në Karaibe të



aeroplanmbajtëses gjigante Gerald R. Ford, me rreth pesë mijë marinare dhe më shumë se 75 avionë luftarakë dhe mbështetës, përfshirë F/A-18. Që nga fundi i gushtit, numri i trupave amerikane në rajon është rritur. Edhe pa aeroplanmbajtësen, në zonë ndodhen rreth dhjetë mijë ushtarë, të dislokuar në anije luftarake dhe në bazat amerikane në Porto Riko. Në javët e fundit, Pentagoni ka dërguar bombardues B-52 dhe B-1 nga bazat në Luiziana dhe Teksas për misionet fluturimi pranë brigjeve venezuelane, të cilat përshkruhen nga ushtria si "demonstrim force". B-52 mund të mbajnë dhjetëra bomba precizioni, ndërsa B-1 kanë kapacitet ngarkese prej 34 mijë kilogramësh municione. Edhe Regjimenti i 160-të i Operacioneve Speciale Ajrore, i njohur për misionet e tij të gjera antiterroriste në Afganistan, Irak dhe Siri, së fundmi ka kryer stërvitje pranë ujërave venezuelane. Ky dislokim i shpejtë dhe i hapur i forcave sugjeron një fushatë presioni psikologjik ndaj Maduros. Trumpi ka përmendur mundësinë e miratimit të një dokumenti që do t'i jepte CIA-s autorizim për operacione të fshehta në Venezuelë, një veprim që presidentët rrallë e bëjnë

publikisht. Nëse Trumpi do të urdhëronte një ndërhyrje tokësore në Venezuelë, ai do të ekspozohej ndaj rreziqeve të mëdha ushtarake, ligjore dhe politike. Edhe pse autorizoi bombardimin e tre impianteve bërthamore në Iran në qershor, qëllimi atëherë nuk ishte rrëzimi i regjimit në Teheran. Në Venezuelë, nuk do të kishte asnjë garanci suksesi, dhe aq më pak siguri se rrëzimi i Maduros do të sillte një qeveri më të afërt me Shtetet e Bashkuara. Sipas bashkëpunëtorëve të tij, shumë më tepër energji i është kushtuar planifikimit të një sulmi kundër qeverisë së Maduros sesa asaj që do të ndodhte më pas, në rast se operacioni do të kishte sukses. Disa prej aleatëve më të përkushtuar politikë të Trumpit e kanë paralajmëruar atë kundër nisjes së një operacioni të tillë, duke i kujtuar se ai është zgjedhur për t'i dhënë fund "luftërave të pafundme", jo për të nisur të reja.

Një plan me tre faza

CIA do të mund të ndërmerre disa lloje aktivitete: misionet të inteligjencës, mbështetje për krijimin e një opozite të brendshme, sabotim aktiv të qeverisë apo edhe kapjen e Maduros. Megjithatë, sipas disa

zyrtarëve amerikanë të sigurisë, nëse operacione të tilla do të kishin pasur mundësi reale të largonin presidentin venezuelan, kjo do të kishte ndodhur prej vitesh. Pikërisht për këtë arsye Shtëpia e Bardhë po shqyrton mundësinë e një ndërhyrjeje ushtarake. Në tryezë ndodhen tre propozime. Faza e parë parashikon sulme ajrore kundër instalimeve ushtarake, disa prej të cilave lidhen me trafikun e drogës, me synimin për të dobësuar mbështetjen e ushtrisë ndaj Maduros. Nëse presidenti venezuelan do të besonte se nuk ka më mbrojtjen e forcave të armatosura, ai mund të përpiqej të arratisë. Kritikët paralajmërojnë se një veprim i tillë mund të prodhojë efektin e kundërt: forcimin e mbështetjes popullore rreth një lideri të vendosur nën rrethim. Opsioni i dytë parashikon përdorimin e forcave speciale amerikane, si Delta Force ose Seal Team 6, për të arrestuar ose eliminuar Maduron. Administrata Trump do të përpiqej të anashkalonte ndalimin ligjor për vrasjen e krerëve të shteteve të huaja duke argumentuar se Maduro është mbi të gjitha kreu i një karteli narkoterrorist; një argument i ngjashëm me atë që u përdor për të justifikuar sulmet ajrore ndaj anijeve të

akuzuara për trafik droge. Departamenti i Shtetit ka vendosur një shpërblim prej 50 milionë dollarësh për arrestimin ose dënimin e Maduros, një rritje e konsiderueshme krahasuar me 25 milionët e ofruar nga administrata Biden. Shtëpia e Bardhë mund të mbështesë gjithashtu idenë se, për shkak të represionit ndaj opozitës dhe manipulimit të zgjedhjeve të fundit, Maduro nuk është më një udhëheqës legjitim i shtetit. Opsioni i tretë, më kompleks, do të përfshinte dislokimin e forcave amerikane kundër terrorizmit për të marrë nën kontroll aeroportet dhe disa prej vendburimeve kryesore të naftës dhe infrastrukturave strategjike të Venezuelës. Dy opsionet e fundit mbartin rreze të mëdha për forcat amerikane në terren, pa përmendur edhe rrezikun e qartë për civilët, sidomos nëse objektivi do të ishte kapja ose neutralizimi i Maduros brenda një mjedisi urban, siç është Karakasi. Trumpi është treguar hezitues për të konsideruar operacione që vënë në rrezik jetën e ushtarëve amerikanë. Për këtë arsye, shumë prej planeve që po shqyrtohen parashikojnë përdorimin e dronëve detarë dhe armëve me rreze të gjatë veprimi.

Dilema e naftës

Presidenti i Shteteve të

Bashkuara është i interesuar për rezervat gjigante të naftës së Venezuelës, më të mëdhatë në botë. Menaxhimi i atyre burimeve ka qenë prej dhjetë muajsh një çështje e pazgjidhur për administratën, e cila nuk ka vendosur nëse duhet të ndërpresë importet amerikane apo t'i mbajë ato, me shpresën për të ruajtur një pozicion të privilegjuar në rast të rrëzimit të Maduros. Edhe pasi Trumpi dyfishoi shpërblimin për kapjen e liderit venezuelan dhe e quajti “narkoterrorist”, ai e anuloi, dhe më pas rinovoi, licencën që i lejon Chevron-it, gjigantit amerikan të naftës, të vazhdojë operacionet në vendin latino-amerikan. Nën presionin e sekretarit të Shtetit, Rubio, licenca e Chevron-it u revokua në mars, dhe gjatë verës eksportet venezuelane drejt SHBA ranë në mënyrë drastike. Një licencë e re, detajet e së cilës nuk janë bërë publike, duket se i ndalon kompanisë të transferojë valutë të huaj në sistemin bankar venezuelan. Megjithatë, eksportet e naftës së Chevron-it vijnë të përbëjnë një mbështetje të rëndësishme ekonomike për Maduron. Chevron-i është përjashtim: shumica e aseteve të kompanive të tjera amerikane të naftës që operonin në Venezuelë janë konfiskuar ose kaluar nën kontrollin e ndërmarrjeve shtetërore venezuelane vite më parë. Chevron është ndër të paktat që ka ditur të manovrojë

mes Trump-it dhe Maduros, i cili ka deklaruar: “Chevron ka qenë në Venezuelë prej 102 vitesh dhe dua të qëndrojë edhe njëqind të tjera”. Kompania ka angazhuar në Uashington një lobist të rëndësishëm, donator të madh të fushatës së Trump-it. Në muajt e fundit, Maduro ka tentuar ta tërheqë Trump-in duke ofruar koncesione, përfshirë një pjesëmarrje dominuese në nxjerrjen e naftës dhe burimeve të tjera minerare të vendit. Ai u ka premtuar kompanive amerikane kontrata të privileguara për projektet aktuale dhe të ardhshme që lidhen me arin dhe naftën. Madje ka sugjeruar se është i gatshëm të riorientojë eksportet drejt Kinës dhe të kufizojë bashkëpunimet me kompani kineze, iraniane e ruse. Në fillim të tetorit, Trumpi refuzoi ofertën, dhe përshkallëzimi ushtarak amerikan u shpejtua ndjeshëm. Nëse regjimi i Maduros do të binte dhe zëvendësohej me një udhëheqje të qëndrueshme e më miqësore ndaj Uashingtonit, Chevron do të ishte ndër përfituesit kryesorë të atij që administrata Trump e imagjinoi si një bum të investimeve në rezervat kolosale të naftës venezuelane. Ideja e ka intriguar Trump-in, ashtu si e kishte intriguar edhe kontrolli mbi vendburimet siriane, pavarësisht se rezervat e tyre janë shumë më të kufizuara. “Besojmë se prania jonë mbetet një faktor

stabilizues për ekonominë lokale, rajonin dhe sigurinë energjetike të Shteteve të Bashkuara”, ka deklaruar Bill Turenne, zëdhënës i Chevron-it. Ndërsa bashkëpunëtorët e Trump-it shtojnë drejt opsionit ushtarak më agresiv, avokatët e Departamentit të Drejtësisë po hartojnë një kornizë ligjore që mbulon të gjitha veprimet e debatuar. Zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë kanë kërkuar një analizë juridike të përditësuar para se të ndërmerren hapa të tjerë, dhe juristët e qeverisë u kanë deklaruar anëtarëve të Kongresit se presidenti nuk ka nevojë për autorizimin e tyre për goditjet vdekjeprurëse kundër anijeve që vijnë nga Venezuela. Elliot Gaiser, drejtor i zyrës së këshillimit ligjor të Departamentit të Drejtësisë, u ka thënë ligjvënësve se sipas interpretimit të qeverisë, operacionet kundër anijeve venezuelane nuk përbëjnë një akt armiqësor në kuptimin e War Powers Resolution të vitit 1973, i cili kërkon autorizimin e Kongresit për veprime ushtarake që zgjasin mbi gjashtëdhjetë ditë. Por si demokratët, ashtu edhe republikanët, kanë shprehur shqetësim për këto sulme.

Kërkimi i një baze ligjore

Ndoshta precedenti më i afërt për të justifikuar goditjen e një kreu shteti është opinioni i përgatitur nga po e njëjta zyrë

gjatë mandatit të parë të Trump-it. Sipas tij, presidenti kishte autoritetin të urdhëronte sulmin me raketë që vrau gjeneralin Qassem Soleimani, figurën kryesore të inteligjencës dhe sigurisë iraniane, i cili u eliminua nga dronët amerikanë në vitin 2020. Trumpi e ka përshkruar atë operacion si një nga arritjet madhore të mandatit të tij. Në atë rast, zyra ligjore vlerësoi se përdorimi i dronëve ishte i justifikuar sepse Soleimani “po zhvillonte aktivisht plane për sulme të reja kundër personelit ushtarak dhe diplomatik amerikan”, sipas një memorandumi të publikuar pas sulmit. “Udhëheqësit ushtarakë që planifikojnë dhe drejtojnë sulme kundër qytetarëve ose interesave të SHBA mund të konsiderohen objektiva të ligjshëm ushtarakë”, thuhej në dokument. Memorandumi theksonte se operacioni ishte hartuar “për të shmangur viktimat civile ose dëmet e konsiderueshme kolaterale” dhe se nuk synonte “të impononte me mjete ushtarake një ndryshim të natyrës politike të regjimit”. Dokumenti përfundonte se, “duke pasur parasysh natyrën e misionit, informacionin e disponueshëm të zbulimit dhe masat e marra për të shmangur përshkallëzimin”, një sulm me dron ndaj tij “sipas kushtetutës nuk do të konsiderohej si akt lufte”. / *The New York Times* – *Bota.al*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova fiton ndaj Shqipërisë në rrugën për Eurobasket

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Kosova ka shënuar fitore me rezultat 99-84 ndaj Shqipërisë, në takimin e zhvilluar në qytetin e Shkodrës, në kuadër të Grupit C, për kualifikimet e Eurobasketit. "Dardanët" e

kanë nisur shumë mirë takimin duke e bërë dallimin në çerekun e parë, i cili doli të jetë vendimtar për fitore. 25-14 ishte rezultati i këtij çereku, derisa në çerekun e dytë Kosova ka shtuar edhe 5 pikë

të tjera në këtë epërsi duke triumfuar 19-14. Pjesa e dytë ishte më e balancuar, ku Shqipëria ka fituar çerekun e tretë 32-30, ndërsa e ka humbur të katërtin 25-24. Më të mirët në këtë takim ishin

Dardan Berisha që ka shënuar 35 pikë e dhuroj 6 asistime, i ndihmuar nga Erjon Kastrati me 21 pikë. Te Shqipëria, Julian Hamati ka shkëlqyer me double-double me 19 pikë dhe 10 kërcime.



BALLKANI, LIDER I SUPERLIGËS

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Në kuadër të xhiros së 15-t Ballkani ka shënuar fitore të madhe në udhëtim ndaj kampiones në fuqi, Dritës, duke e mposhtur me rezultat 3:2, në njërin nga ndeshjet më të mira të këtij edicioni dhe jo vetëm. Kjo sfidë ka shënuar debutimin me fitore të trajnerit të ri të portokallezinjve, Mislav Karoglan. Skuadra suharekase e ka nisur ndeshjen fuqishëm, me Bleart Tolajn që ka shënuar një supergol në minutën e 12-të. Drita ka reaguar shpejt duke barazuar në minutën e 23-të përmes Kristal Abazajt. Por, Ballkani është përgjigjur me dy gola brenda dy minutave: Giovanni Ribeiro në minutën e 32-të dhe Walid Hamidi në të 34-n kanë përfunduar një pjesë të parë të shkëlqyer për mysafirët. Në pjesën e dytë Drita ka dominuar dhe ka shënuar edhe një gol tjetër me Abazajn në minutën e 58, por pavarësisht prej rasteve të

shumta, nuk ka arritur ta shmangë humbjen. Në minutën e 88, GERALB Smajli i Ballkanit është përjashtuar me karton të kuq. Me këtë fitore, Ballkani ka marrë kreun e tabelës me 26 pikë, sa ka edhe Prishtina, por suharekasit kanë një ndeshje më shumë të zhvilluar. Drita, ndërkohë, renditet në pozitën e katërt me 23 pikë. Dukagjini ka regjistruar fitoren e tretë rresht në kampionat, duke mposhtur Llapin, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, me rezultat minimal 1:0. Në një takim të luftuar deri në minutën e fundit, ka vendosur goli i Dardan Morinës në minutën e 90, pas një kundërsulmi të shpejtë. Fitore si mysafire ka realizuar edhe Malisheva, e cila ka regjistruar fitoren e dytë rresht dhe të shtatën këtë edicion, teksa mposhti Ferizajn, me rezultat 2:0. Me këtë triumf, Malisheva ngjitet në vendin e pestë me 22 pikë, ndërsa Ferizaj mbetet në zonën e ftohtë, duke



zënë pozitën e parafundit me 15 pikë dhe pa fitore në katër ndeshjet e fundit. Fitore të rëndësishme kanë shënuar edhe Prishtina e Re dhe Gjilani. Në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, Prishtina e Re ka arritur fitore bindëse 4:1

ndaj Prishtinës, duke i dhënë fund serisë pa fitore mbi dy muaj. Prishtina, e cila është e dyta në tabelë, vazhdon të kalojë nëpër një fazë të vështirë, me tri humbje dhe një barazim në katër ndeshjet e fundit, teksa në këtë ndeshje në bankinën e

bardhekaltërve ka debutuar Afrim Tovërlani. Ndërsa në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, Gjilani ka arritur fitore të çmuar ndaj Drenicës. Skuadra e trajnerit Debatik Curri triumfoi 1:0 falë golit të Senad Jaroviqit në minutën e 82-të. Fitorja ia ka mundësuar Gjilanit të ngjitet në pozitën e shtatë me 19 pikë, duke kaluar pikërisht Drenicën që tani zbret në vendin e tetë me 17 pikë.

RENDITJA TABELARE

Ballkani	26
Prishtina	26
Dukagjini	26
Drita	23
Malisheva	22
Llapi	20
Gjilani	19
Drenica	17
Ferizaj	15
Prishtina e Re	14

DONAT HASANAJ, "YLLI I JAVËS" NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË FUTBOLL



PRISHTINË, 1 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në elitën e futbollit të Kosovës. Për javën e 15 të këtij edicioni ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Prishtina e Re, Donat Hasanaj, i cili ka

pasur paraqitje individuale shumë të mirë për skuadrën gjatë 90 minutave të ndeshjes kundër FC Prishtina. Ndonëse mbrojtës, ai ka shënuar gol dhe ka qenë përcaktues edhe në një gol tjetër, derisa ka bërë edhe ndërhyrje shumë të rëndësishme në fazën e mbrojtjes, në fitoren e rëndësishme me rezultat 4:1. Vlerësimi është bërë nga

Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Fatmir Mehmetit, Agim Maliqit dhe Muhamet Sylejmanit. Pasi ka marrë këtë çmim, Hasanaj është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. "Kemi pasur një ndeshje shumë të vështirë kundër FC Prishtina, e cila kryeson në tabelë, por edhe ne jemi përgatitur kundër tyre shumë mirë. Është e vërtetë që

kemi pasur shumë ndryshime, pasi në 15 xhiro janë ndërruar tre trajnerë, por atmosfera momentale është shumë e mirë në skuadër. Si në aspektin individual ashtu edhe në atë ekipor kemi luajtur shumë mirë dhe e shfrytëzojmë rastin t'i falënderoj bashkëlojtarët për kontributin, që unë ta marr këtë çmim sot", ka thënë Hasanaj për faqen zyrtare të FFK-së.

Dy klubet e mëdha të Premierligës angleze në garë për Roko Vatën

Dy klubet e mëdha të Premierligës, Fulham dhe Crystal Palace, janë në garë për të nënshkruar me sulmuesin e talentuar Roko Vata. Ai ka dëshmuar kualitetin në Championship në fanellën e Watfordit, ndërsa tani është duke u rikuperuar nga lëndimi si dhe pritët të rikthehet në

muajin janar. Megjithatë, ekziston mundësia që Vata të jetë i veshur me një tjetër fanellë, pasi pëlqehet tej mase nga Fulhami dhe Crystal Palace. "Daily Mail" ka raportuar se të dy klubet angleze e kanë kontaktuar lojtarin, kurse Watford do t'ia hapte derën

nëse paguhet klauzola e lirim të vlerën e 20 milionë funteve. Vata është pjesë e Irlandës në nivelin ndërkombëtar, megjithatë ka të drejtë t'i bashkohet Shqipërisë dhe Kosovës, pasi nuk ka zhvilluar ende tri paraqitje zyrtare. Edhe babai i tij, njëkohësisht legjenda e Shqipërisë, Rudi Vata, për

"Telegrafi"-in ka konfirmuar se ekziston mundësia që lojtari të ndryshojë përfaqësuesen. "Ka luajtur një ndeshje me Irlandën, e cila normalisht ka treguar seriozitet dhe respekt. E kanë treguar në të gjitha mënyrat e mundshme në aspektin profesional. Nuk e di se çfarë mendon Roko nëse



ndonjë federatë e kontakton, gjithçka është e hapur", ka deklaruar Vata kur është pyetur nëse Roko mund të luajë për Kosovën ose Shqipërinë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bleta Shped” Sh.P.K. me seli në Mitrovicën Veriore, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811164277 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bleta Shped” D.O.O. od Severna Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811164277 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bleta Shped” L.L.C. with headquarters Mitrovica Veriore, has come to the decision to quit its business: 811164277 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rinori Rs Transport” SH.P.K. pronar Rinor Sinani me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812308494 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rinori Rs Transport” D.O.O. Rinor Sinani Lipjan donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812308494 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Rinori Rs Transport” L.L.C. with owner Rinor Sinani with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 812308494 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alban Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Hani Hotit” SH.P.K. me nr. Unik: 811577751.

- Shemsije Rakipi shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ilmi Bahtjari" Prizren.

- Egzon Makolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Drenas.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

